



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 615/5 Prot

Tiranë, më 07.09.2021

V E N D I M

Nr.102, datë 07.09.2021

**Mbi përfundimin e hetimit administrativ, mbi vlerësimin e ligjshmërisë së ecurisë
disiplinore ndaj nëpunëses *******

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, për trajtimin e informacionit të përcjellë nga nëpunësja ***** , për shkelje të legjislacionit të shërbimit civil gjatë zhvillimit të procedurës disiplinore,

VËREJ SE:

Nëpërmjet informacioneve të regjistruara me nr. 615 prot., datë 10.05.2021; nr. 615/1 prot., datë 18.05.2021, kërkuesja ***** , kundërshton motivacionin e ecurisë disiplinore “Shkelja e rregullave të etikës”, në përfundim të së cilës, është vendosur marrja e masës disiplinore “Vërejtje”.

Nga këqyrja e dokumentacionit të mbledhur gjatë zhvillimit të hetimit administrativ, konstatohet që punonjësja ***** është nëpunëse civile pranë Bashkisë Gjirokastrë dhe

kryen detyrën “*Specialist transparenca në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Shërbimeve, Arkivës dhe Protokollit*”.

Ecuria disiplinore ndaj kësaj nëpunëseje ka filluar si pasojë e mospërbushjes së detyrës dhe vonesës në kthimin e përgjigjes ndaj një kërkuesi, i cili, nga ana e tij, në mungesë të një përgjigje kundrejt kërkesës për informacion drejtuar Bashkisë Gjirokastrë, i është drejtuar “*Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për refuzim të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin për dhënien e informacionit të kërkuar. Ky i fundit, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të ankesës, ka kërkuar sqarim nga ana e Bashkisë Gjirokastrë. Kjo situatë është bërë shkak që Sekretari i Përgjithshëm, ti komunikojë nëpunëses “*Vërejtjen*” e propozuar prej tij, përpara “*Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Shërbimeve, Arkivës dhe Protokollit*” (akti nr. 256, datë 10.05.2021).

Nëpunësja ***** e ka quajtur të padrejtë këtë propozim dhe e ka kundërshtuar atë duke ngritur zërin dhe duke përplasur derën, akte këto që janë evidentuar në “*Ankesën*” që Sekretari i Përgjithshëm, ka paraqitur përpara Komisionit Disiplinor dhe Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Shërbimeve, Arkivës dhe Protokollit, si veprime në thyerje të Kodit të Etikës, parimit të përgjegjshmërisë në punë dhe mosrespektim të eprorit. Nisur nga sa më sipër, si dhe për të mënjeluar sjellje të ngjashme të cilat çënojnë figurën e eprorit dhe për të ndaluar çdo veprim të papranueshëm nga çdo nëpunës tjetër, Sekretari i Përgjithshëm i bashkisë ka thirrur Komisionin Disiplinor.

Në vijim, rezulton se në datën 11.5.2021 është zhvilluar seanca dëgjimore në Komisionin Disiplinor, ku kanë marrë pjesë eprori direkt, përfaqësuesi i njësisë së burimeve njerëzore dhe nëpunësi i proceduar. Në këtë seancë është shqyrtuar shkelja e pretenduar dhe nëpunësja ka dhënë sqarimet e veta në lidhje me këtë rast.

Nga përmbajtja e procesverbalit të mbledhjes së Komisionit Disiplinor, rezulton se nëpunësja e proceduar, ka pranuar faktet e ndodhura në lidhje me shkeljen e pretenduar, por nuk ka qenë dakord me përgjegjësinë që i ngarkohej në lidhje me detyrën, pasi sipas saj, atë duhej ta ndiqte Drejtoria Rajonale e Bujqësisë. Ndërsa vijimin e procedurës disiplinore, e quan tendencioze dhe të pabazë.

Pas shqyrtimit të provave për shkeljen disiplinore të pretenduar dhe pas administrimit të thënieve të nëpunëses së proceduar, Komisioni Disiplinor, me vendimin nr. 49, datë 14.05.2021 “*Për masë disiplinore*”, ka dhënë orientime për marrjen e një mase disiplinore të lehtë, e cila nuk është në kompetencë të këtij organi.

Për këtë arsye, procedura ka vijuar më tej nga Drejtori i Burimeve Njerëzore, si eprori direkt i nëpunëses në fjalë, që është dhe organi kompetent për atë kategori shkeljeje. Në këto rrethana, bazuar në ligjin nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, nenin 60, pika 1, shkronja *“a”*, *“b”* dhe *“c”* të tij, si dhe VKM nr, 115, datë 5.3.2014, eprori direkt, me vendimin nr. 290, datë 14.05.2021, ka vendosur që punonjëses ***** me pozicion *“Specialiste Transparence në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Shërbimeve, Arkivës dhe Protokollit”* t’i jepet masa disiplinore *“Vërejtje”* dhe kjo masë të regjistrohet në dosjen e personelit.

Në përfundim të gjithë sa u arsyetua më sipër, Komisioneri konstaton se akti i vetëm që ka sjellë si pasojë marrjen e masës disiplinore dhe administrimin e saj në dosjen personale të nëpunësit civil, është vendimi nr. 290, datë 14.5.2021, i eprorit direkt për dhënien e masës disiplinore *“Vërejtje e lehtë”*, për nëpunësen *****.

Në këto rrethana, Komisioneri çmon se nëpunësja është njohur me shkeljet e pretenduara; është dëgjuar dhe ka patur mundësi të mbrohet në lidhje me to dhe, në përfundim, procesi është finalizuar me marrjen e masës disiplinore nga organi kompetent, që është eprori direkt.

Nga gjithë sa u parashtrua më sipër, nisur nga përmbajtja e dokumentacionit në të cilat materializohet procedura disiplinore, arrihet në konkluzionin se, si nga pikëpamja procedurale ashtu dhe ajo materiale, janë respektuar të gjitha kërkesat e ligjit, duke filluar nga momenti i konstatimit të shkeljes disiplinore, vënies në dijeni për këtë fakt, të personit që pretendohet se ka kryer shkeljen, dëgjimin e thënieve të tij dhe administrimin e provave materiale të nevojshme, deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në nenin 90 pika 1, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, si dhe në nenin 34, pika 1, të të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ, me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së ecurisë disiplinore dhe vendimit për *“Vërejtje”* për nëpunësen ***** dhe arkivimin e çështjes.

2. Të njoftohet për këtë vendim Bashkia Gjirokastër dhe për nëpunësja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha